



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC

Nr. _____ Prot.

Pogradec, më 02.05.2025

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT, NË PËRFUNDIM TË AFATEVE TË ANKIMIT

Data: 02.05.2025

Drejtuar:

Operatorit Ekonomik(OE): "REJ" shpk, me Nipt J93711608Q, me adresë: Tirane Zogu i Zi, Qatar Center, kati 2, si dhe me administrator z. Luan Kapri.

Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë (BOE) ☐

[Emrat, Nipt-et, % përkatëse dhe adresat e anëtarëve të BOE]

- OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ **JO** ☒

Nëse po, të jepen dhënat: _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

-OE/BOE me Subjekt Mbështetës:

PO ☐ **JO** ☒

Nëse po, të jepen dhënat: _____

[Emrat, Nipt-et, përkatëse dhe adresat]

Tipi i Kontratës : **Pune publike**

Lloji i Procedurës së prokurimit: **“Procedure e hapur e Thjeshtuar – Pune - Elektronike”**

Numri i Procedurës / Referenca e Lotit: **REF-42532-03-26-2025**

Përshkrimi i shkurtër i kontratës:

Objekti: “Rikonstruksion i Qendrës Multifunksionale”.

Fondi limit: 3 886 722 (tre milion e tetëqind e tetëdhjetë e gjashtë mijë e shtatëqind e njëzet e dy) lekë pa TVSH.

Kohëzgjatja e kontratës/marrëveshjes kuadër ose afati për zbatimin e saj: 4 Javë nga marrja në dorëzim e sheshit të ndërtimit.

Data e Publikimit në SPE të Njoftimit të Fituesit nga i cili nisin afatet e ankimit/Njoftimit të anulimit nga i cili nisin afatet e ankimit: 25.04.2024

¹Data e Publikimit në Buletinin e Njoftimeve Publike të Njoftimit të Fituesit nga i cili nisin afatet e ankimit /Njoftimit të Anulimit nga i cili nisin afatet e ankimit : *Data : 28.04.2025 , Numri: 21*

KRITERET E PËRZGJEDHJES SË FITUESIT:

-oferta ekonomisht më e favorshme bazuar në kosto ☐

-oferta ekonomisht më e favorshme bazuar në çmim ☒

Me anë të këtij Formulari, ju informojmë se, në këtë procedurë/lot kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me vlerat përkatëse të ofruara:

1.(BOE):"ADA-CO" shpk, me Nipt K64112603J dhe

“DESARET COMPANY” shpk, me Nipt K01816001J

Vlera: 2 923 387 (dy milion e nëntëqind e njëzet e tre mijë e treqind e tetëdhjetë e shtatë) lekë pa tvsh.

OE/BOE me nënkontraktor:

PO ☐ JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

2.“ÇELA GROUP” shpk, me Nipt M22610207Q

Vlera: 2 499 895 (dy milion e katërqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e tetëqind e nëntëdhjetë e pesë) lekë pa tvsh.

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

¹Në rastin e procedurave të prokurimit që zhvillohen në rrugë shkresore, plotësohet vetëm data e publikimit të këtyre njoftimeve në BNJP

3. "INFINIT "shpk, me Nipt J74304623M

Vlera : 2 564 920 (dy milion e pesëqind e gjashtëdhjetë e katër mijë e nëntëqind e njëzet) lekë pa tvsh.

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO X

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

4. "REJ" shpk, me Nipt J93711608Q

Vlera : 3 127 138 (tre milion e njëqind e njëzet e shtatë mijë e njëqind e tridhjetë e tetë) lekë pa tvsh.

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO X

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

5. "TIEN" shpk, me Nipt M02302028V

Vlera : 3 449 515 (tre milion e katërqind e dyzet e nëntë mijë e pesëqind e pesëmbëdhjetë) lekë pa tvsh.

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO X

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

Janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

1. BOE: "ADA-CO" shpk me Nipt K64112603J dhe operatori **"DESARET COMPANY" shpk**, me Nipt K01816001J , *per arsyet e mëposhtme:*

Nuk është arritur të paraqitet i *gjithë dokumentacioni i plotë dhe i saktë për të dëshmuar plotësimin e të gjithë kërkesave për kualifikim siç kërkohen në DST.*

Konkretisht:

1.1 BOE nuk përmbush pikën 2.3.4 dhe pikën 2.3.6 të kriterëve të veçanta për kualifikim të DST-së. Ata kanë paraqitur marrëveshjen e bashkëpunimit , ku zotohen se shoqëria "ADA-CO" shpk do të përmbushë 60% të zërave të preventivit dhe shoqëria "DESARET COMPANY" shpk do të përmbushë 40% të zërave të preventivit, te percaktuara qarte dhe ne preventiv.

Duke u nisur nga kjo marrëveshje bashkëpunimi dhe nga kjo përqindje pjesmarrje për secilin operator, ata do te duhej te provonin përmbushjen e dokumentacionit te kërkuar nga Autoriteti

Kontraktor (AK) dhe të përcaktuar nga legjislacioni i prokurimeve, sipas kësaj përqindje bashkëpunimi, pra ne raportin 60 % me 40%.

Nga verifikimi i Formularit të vetëdeklarimit “Shtojca 8”, e paraqitur nga shoqëria “DESARET COMPANY” shpk rezulton se operatori nuk ka deklaruar mbi disponimin e fuqisë punëtore dhe makinerive të nevojshme për përmbushjen me sukses të kontratës, ne masen 40 % të deklaruar në marreveshjen e bashkëpunimit. BOE ka specifikuar në preventivin e paraqitur ndarjen e zërave sipas përqindjes të përcaktuar prej tyre, por nuk kanë deklaruar në 8 , Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit disponimin e fuqisë punëtore dhe makinerive e pajisjeve ne raportin 60% me 40%, të nevojshme për kryerjen me sukses të objektit.

Mbështetur në pikën 3 të nenit 88 “Bashkimi i operatorëve ekonomikë” të VKM-së Nr. 285 date 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” e ndryshuar, ku citohet se: “*Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.*”

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO X

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

2. “ÇELA GROUP” shpk, me Nipt M22610207Q, për arsyet e mëposhtme:

Nuk ka arritur të paraqesë të gjithë dokumentacionin e plotë dhe të saktë për të provuar plotësimin e të gjithë kërkesave për kualifikim ashtu siç deklaroi në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, në përputhje me DST-në.

Konkretisht;

2.1 OE nuk përmbush pikën 2.3.4 të kriterëve të veçanta për kualifikim të DST-së, (Punonjës të kualifikuar), si më poshtë:

Nga verifikimi i dokumentacionit fizik të paraqitur nga OE “ÇELA GROUP” shpk, rezulton se në përmbushje të pikës 2.3.4 të kapacitetit teknik, OE ka paraqitur për specialistët e kërkuar (specialist ndertimi, pllakashtrues, suvatures, shtrues parketi dhe elektrikist,) certifikata trajnimit të lëshuara nga Shoqëria “Re/Born” shpk me Nipt L71309019P, e cila rezulton se nuk është e akredituar sipas ligjit Nr.15/2017 "Për arsimin dhe formimin profesional në RSH" për ofrimin e kurseve profesionale për profesionet e mësipërme. Sipas kerkimeve në faqen zyrtare të QKB-së, rezulton se Shoqëria “Re/Born” shpk ka pesë miratime për dhënie të kurseve profesionale nga Ministria e Financës, nga të cilat nuk rezulton asnjë miratim për profesionet e mësipërme.

Shoqëria Re/Born është e pajisur me licencën me nr LN-7449-06-2019 për ofrimin e kurseve profesionale, ku përfshihen sipas miratimeve:

- Sipas miratimit nr.10051/2 prot datë 06.06.2019, Shoqëria "Re/Born" shpk është e akredituar për ofrimin e kurseve profesionale në: "Sisteme Menaxhimi sipas standarteve ISO 9001: 14001 OHSAS 18001",
- Sipas miratimit nr.3395/2 prot datë 16.03.2021, Shoqëria "Re/Born" shpk është e akredituar për ofrimin e kurseve profesionale në: "Përgjegjës për shëndetin dhe sigurinë në punë" dhe "Plane emergjencash dhe evakuim nga zjarri dhe Auditor dhe kontrollator HACCP"
- Sipas miratimit nr.16975/2 prot datë 04.10.2023, Shoqëria "Re/Born" shpk është e akredituar për ofrimin e kurseve profesionale në: "Operator në shërbime funërale", "Operator në transportin e të ndjerit", "Menaxher teknik dhe operacional në shërbime funërale", "Menaxhimi mjedisor dhe I mbetjeve të aktivitetit të punës", "Identifikimi dhe vlerësimi mjedisor dhe I ndikimeve në mjedis", "Menaxhim I emergjencave mjedisore" dhe "Monitorimi dhe vlerësimi I mikroklimave në ambientet e punës (pluhurat, zhurmat, ndricimi)."
- Sipas miratimit nr.23202/2 prot datë 17.01.2023, Shoqëria "Re/Born" shpk është e akredituar për ofrimin e kurseve profesionale në: "Njohuri dhe Auditor i Brendshëm për ISO : 27001; 17020; 17021; 17024, dhe "Kordinator i shëndetit dhe sigurisë në punë në kantierë"
- Sipas miratimit nr. 8716/2 prot datë 20.06.2023, Shoqëria "Re/Born" shpk është e akredituar për ofrimin e kurseve profesionale në: "Mbrojtje nga zjarri dhe shpetimi", "Përgjegjës kompanie për emergjencat, evakuimin dhe mbrojtjen nga zjarri", "Njohuri dhe përdorim I mjeteve të fikjes së zjarreve" dhe "Ndihma e parë dhe Higjiena në punë".

Pra, duke qenë se certifikatat e mësipërme për specialistë të kërkuar në DST dhe të deklaruar nga OE, nuk janë të leshuara nga institucionë publike/privatë të licensuara sipas ligjit 17/2015 "Për arsimin dhe formimin profesional në R.SH", për profesionet (specialistët) e kërkuar, subjekti "Re/Born" shpk nuk është i autorizuar për të ofruar kurse për këto trajnime dhe për rrjedhojë as për të leshuar certifikata për këto trajnime.

2.2 OE nuk përmbush pikën 2.3.6 të kriterëve të veçanta për kualifikim të DST-së, *(Makinë dhe Pajisje)*, si më poshtë:

Në përmbushje të pikës së mësipërme, ku kërkohet disponimi i:

- 1 (një) kamioncine deri në 3.5 ton dhe
- 1 (një) Autovetëshkarkuese 3.5 deri në 7 ton,

Operatori ekonomik ka paraqitur kontratën e qirase Nr. Rep. 1513, Nr. Koleksioni 747, datë 12.04.2025, me subjektin "BAJRAMI-N" shpk, për dhënie me qira të mjeteve "Kamion", me targa AA 208 NE dhe "Kamion", me targa AA 115 KZ, nga verifikimi i dokumentacionit të të cilave rezulton se kapaciteti mbajtës i të dy mjeteve nuk është në përputhje me ato të kërkuara, konkretisht për mjetin kamioncinë është paraqitur mjeti "Kamion" me kapacitet mbajtës 3850 kg ose 3.85 ton.

Ndërsa për sa i përket mjetit Autovetëshkarkuese të kërkuar nga AK , 3.5 deri 7 ton, OE ka paraqitur mjetin “Kamion”, me kapacitet mbajtës 17,100 kg ose 17 ton, i cili është në tejkalim të kapacitetit të kërkuar.

Për secilin prej ketyre mjeteve, janë paraqitur certifikata të transportit të mallrave, për llogari të vetë, të cilat rezultojnë të kenë përfunduar më datë 31.05.2024.

Pra, në analizë të sa më sipër cituar, OE ka lidhur kontratatë qiraje për të 2 (dy) mjetet e kërkuara në DST, pavarësisht faktit se nuk i ka bashkengjitur certifikata transporti për të tretë dhe me qira, bazuar në nënin 41, të ligjit nr. 8308, datë 18.3.1998 "Për transportet rrugore", i ndryshuar, ku parashikohet se: "Transporti i mallrave me qira dhe për të tretë është i ndaluar të kryhet pa licencën përkatëse".

Në rastin konkret përmes dokumentacionit të dorëzuar vërtëtohet se, certifikatat e paraqitura (afati i vlefshmerise se tyre ka përfunduar), rezultojnë të jenë dhënë në përdorim të vet pronarit të mjetit për kryerjen e transportit të mallrave me kamion (vetëm për llogari të veprimtarisë së vet). Në këtë mënyrë, kryerja e transportit nga ana e OE të mallrave me mjetin e mësipërm do të jetë në kushtet e kryerjes së transportit të mallrave me qira dhe për të tretë pa certifikatën përkatëse, transport i cili në zbatim të nënit 41 të ligjit "Për Transportet Rrugore" është i ndaluar. Mungesa e certifikatave të mësipërme, vërtëton faktin se përdorimi i tij nga të tretë do të ishte i pamundur në zbatim të dispozitave të sipërcituara të Kodit Rrugor të RSh-së dhe të ligjit "Për Transportin Rrugor".

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO X

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

3.“INFINIT” shpk, me Nipt J74304623M, per arsyet e mëposhtme:

Për operatorët e kualifikuar bëhet kontrolli për oferta anomalisht të ulëta, sipas formulës të zbatuar sipas DST (Në rast kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, në përputhje me nenin 93 të LPP-së, oferta konsiderohet anomalisht e ulët nëse vlera e saj do të jetë më pak se 25% e fondit limit).

Fondi Limit :3 886 722 leke

25% e 3 886 722= 971 680.5 leke

3 886 722 – 971 680.5 = **2 915 041, 5 leke**

Komisioni i vlerësimit të ofertave pas zbatimit të formulës së mësipërme, vë re se oferta e OE “INFINIT” shpk, me Nipt J74304623M me vlere prej **2 564 920 (dy milion e pesëqind e gjashtëdhjetë e katër mijë e nëntëqind e njëzet) lekë pa tvshështë** anomalisht e ulët.

Mbeshtetur ne Ligjin nr.162/2020 “Per prokurimet publike” i ndryshuar ne nenin 93 pika 5 thuhet: “Në procedurat e prokurimit me vlerë nën kufijtë e lartë monetarë, autoritetet ose entet kontraktore refuzojnë pa kërkuar shpjegime një ofertë, e cila është konstatuar anomalisht e ulët.”

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO X

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

4. "TIEN" shpk, me Nipt M02302028V ,per arsyet e mëposhtme:

Nuk është arritur të paraqitet i *gjithë dokumentacioni i plotë dhe i saktë për të dëshmuar plotësimin e të gjithë kërkesave për kualifikim siç kërkohen në DST.*

Konkretisht:

4.1 OE nuk përmbush pikën 2.3.2 të kriterëve të veçanta për kualifikim të DST-së (Licenca), pasi "TIEN" shpk ka paraqitur Licencën e tij të shoqërisë por kategoritë e percaktuara në të, nuk janë ato të kërkuara nga AK. Përkatësisht mungon kategoria N.S – 14A Impiante të brendshme, elektrike, telefoni, radiotelefoni TV etj.

4.2 Gjithashtu shoqëria ofertuese "TIEN" shpk deklaron në *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8* se do të mbështetet tek subjekti "Martini Konstruksion & Real Estate" shpk me Nipt K81314023A, me punonjës të kualifikuar sipas pikës 2.3.4 të kriterëve të veçanta për kualifikim të DST-së, për të cilën kanë lidhur akt-marreveshje për mbështetje me punonjes. Referuar kësaj akt-marreveshjeje, OE ofertues "TIEN" shpk do të mbështetet nga OE mbështetës "Martini Konstruksion & Real Estate" me 7 punonjes (Aneksi 1 i marreveshjes), ndërkohë që në Formularin përmbledhës të Vetëdeklarimit në Pjesën 1 të Deklaratës (Informacion mbi subjektet mbështetëse), ka deklaruar se subjekti mbështetës do ta suportojë me: *1 (një) Pllkashtrues 2 (dy) Shtrues Parketi 1 (një) Elektracist 2 (dy) Shofere 3 (tre) Specialistë Ndërtimi* (në total 9 punonjes), ndërsa në Pjesën 3 – Deklarata B (Disponimi i Punonjesve) OE "TIEN" shpk nuk ka parashikuar mbi disponimin e 2 (dy) Shtruesve të Parketit, që kishte deklaruar në seksionin më sipër cituar. Pra, vihet re një mos rakordim midis akt – marreveshjes se lidhur midis paleve, Pjesës 1 dhe Pjesës 3 të Formularit përmbledhës të vetëdeklarimit të dorëzuar nga ofertuesi OE "TIEN" shpk, mbi numrin e punonjesve me të cilët do të mbështetet. Po ashtu, në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, të plotësuar nga subjekti mbështetës "Martini Konstruksion & Real Estate" shpk nuk është deklaruar disponimi i 2 (dy) Shtruesve të Parketit të kërkuar nga AK, duke deklaruar mbështetjen e OE "TIEN" shpk me 7 punonjes në total. Të ndodhur në këto kushte, KVO nuk krijon bindjen se OE disponon të gjithë punonjesit e kërkuar nga AK sipas pikës 2.3.4 të kriterëve të veçanta për kualifikim të DST-së. Në DST citohet se: "Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim."

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë *Operatorin ekonomik: "REJ" shpk*, me Nipt J93711608Q, me adresë: Tirane Zogu i Zi, Qatar Center, kati 2, si dhe me administrator z. Luan Kapri, se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej **3 127 138 (tre milion e njëqind e njëzet e shtatë mijë e njëqind e tridhjetë e tetë) lekë pa tvsh**, është identifikuar si oferta fituese.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë “*Bashkisë Pogradec*” me adrese: Bulevardi "Rreshit Çollaku", Lagja: Nr.2, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 3(tre) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Nese nuk dorëzoni sigurimin e kontratës brenda afatit përfundimtar të parashikuar në dokumentet e tenderit, apo të tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do t’ju konfiskohet sigurimi i ofertës suaj dhe kontrata do t’i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, siç parashikohet në nenin 83 të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar.

Ankesa pas Njoftimit të Fituesit, nga i cili nisin afatet e ankimit /Njoftimit të Anulimit,nga i cili nisin afatet e ankimit

PO ☐ JO ☒

Nëse Po (Nr.__ Datë__ i vendimit përfundimtar për shqyrtimin e ankesës, të dhënë nga Komisioni i Prokurimit Publik)

TITULLAR I AUTORITETIT KONTRAKTOR
KRYETAR
Ilir XHAKOLLI